VENDIM
Nr. 242, datë 2.12.2021

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBESP TRADING & CONSULTING" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 145/3 prot., datë 25.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi licencimin e shoqërisë 'AlbEsp Trading & Consulting' sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 227, datë 9.11.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
- ERE, me shkresën nr. 6/22 prot., datë 10.11.2021, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Shoqëria me shkresat nr. 1021/2 prot. dhe nr. 10.21/3 prot., datë 15.11.2021, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar të këtij aplikimit i cili është reflektuar respektivisht si më poshtë sqaruar në vendim.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar në zbatim të kërkesave të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si më poshtë vijon:
- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b" dhe "c", plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d", "e", plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d", plotësuar;
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pikat: "a", "b" dhe "c", plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti